Vendim nr. 92, datë 09.10.2026

(V- 92/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 08.10.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 28 (S) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SALI BERISHA**, përfaqësuar nga avokatja Klodiana Gjyzari, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorët Arben Kraja dhe Enkeleda Millonai.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1 (87-2025-1), datë 03.01.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-658, datë 22.04.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 17, 38, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 10, 14, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 2 i Protokollit nr. 4 të saj; nenet 27 dhe 71/a e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Sali Berisha *(kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të

interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme)*, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është drejtues i partisë kryesore opozitare, deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe ish-president e ish-kryeministër i vendit. Bazuar në një kallëzim penal të vitit 2020, në bazë të të cilit në vijim është regjistruar procedimi penal nr. 287, me urdhrin e datës 02.10.2023 prokurorët e çështjes kanë shënuar emrin e tij në regjistrin e njoftimit të veprave penale si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 260 e 25 të Kodit Penal *(KP)*. Dyshimet penale lidheshin me veprimet e kryera nga kërkuesi, në cilësinë e Kryeministrit të vendit, për kthimin e pronës shtetërore në favor të 5 familjeve ish-pronare, privatizimin, ndryshimin e destinacionit dhe zhvillimin e saj në favor të disa shtetasve, të cilët, të organizuar në formën e shoqërive tregtare, kanë realizuar ndërtimin e një blloku pallatesh mbi këtë pasuri.

- *Procesi për caktimin e masës së sigurimit (procesi i parë)*

2. Gjatë hetimeve paraprake Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(GJKKO-ja e Shkallës së Parë)* me kërkesë për caktimin ndaj kërkuesit të masave të sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit",* të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*, duke argumentuar se ekzistonin dyshime të arsyeshme, të mbështetura në prova që në ushtrim të pushtetit të tij si Kryeministër kërkuesi kishte kryer veprime të kundërligjshme.

3. Me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 *(vendimi nr. 112/2023)*, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar ndaj kërkuesit masat e sigurimit personal *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* dhe *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit"*. Vazhdimi i zbatimit të këtyre masave është lejuar me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 *(vendimi nr. 117/2023)* të kësaj gjykate dhe është miratuar në vijim nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 05.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Në vijim, ky proces gjyqësor është bërë objekt kontrolli

nga Gjykata Kushtetuese *(Gjykata)*, e cila, me vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 *(vendimi nr. 81/2024)*, ka pranuar pjesërisht kërkesën, duke vendosur shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme vetëm për pjesën që kanë caktuar ndaj kërkuesit masën *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit"*.

- Procesi për konstatimin e humbjes së fuqisë së masave të sigurimit (procesi i dytë)

4. Gjatë kohës që çështja e mësipërme ishte në gjykim, në datën 07.11.2023 kërkuesi i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për konstatimin e humbjes së fuqisë së masave të mësipërme të sigurimit. Kërkesa e tij është rrëzuar me vendimin nr. 442, datë 08.11.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, vendim që është miratuar në vijim me vendimin nr. 165 (87-2023-265), datë 24.11.2023 të GJKKO-së së Apelit. Ndërsa me vendimin nr. 00-2024-390, datë 05.03.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

- Procesi për zëvendësimin in pejus të masës së sigurimit (procesi i tretë)

5. Në kushtet e mosrespektimit nga kërkuesi të masës *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, në datën 22.12.2023, pas marrjes së miratimit nga Kuvendi, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë (gjyqtarit të hetimeve paraprake) me kërkesë për zëvendësimin e saj. Kjo kërkesë është pranuar me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023 të kësaj gjykate, me të cilin ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit *"Arresti në shtëpi"* dhe ai është urdhëruar të mos largohej nga banesa e tij e të mos komunikojë me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të. Ky vendim është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 15 (87-2024-23), datë 25.01.2024, i cili është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-667 (94), datë 09.04.2024. Edhe ky proces është kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatë, e cila, me vendimin nr. 1, datë 17.01.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

- *Procesi për revokimin e masës së sigurimit (procesi i katërt)*

6. Më pas, kërkuesi i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për revokimin e masës së sigurimit personal *"Arresti në shtëpi"*, duke pretenduar se mungonte vepra penale dhe, për rrjedhojë, nuk plotësohej një prej kushteve të përgjithshme për vijimin e zbatimit të masës. Në seancën e caktuar për shqyrtimin e kësaj kërkese, mbështetur në përcaktimet e nenit 246, pika 6, të KPP-së, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur informacionin periodik 2-mujor për gjendjen e procedimit penal. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 125, datë 12.03.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë (gjyqtari i hetimeve

paraprake) ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 73 (87-2024-107), datë 17.04.2024, ndërsa me vendimin nr. 00-2024-1335, datë 16.07.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

- *Procesi për zëvendësimin in melius të masës së sigurimit (procesi i pestë)*

7. Në datën 28.03.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë tjetër në GJKKO-në e Shkallës së Parë, duke kërkuar zëvendësimin e masës *"Arresti në shtëpi"* me një masë më të lehtë. Me vendimin nr. 200, datë 08.04.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e saj. Ky vendim është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 85 (87-2024-121), datë 03.05.2024, ndërsa me vendimin nr. 00-2024-1314, datë 16.07.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

- *Procesi për informacionin 2-mujor të prokurorisë dhe të kërkesës për revokimin e masës së sigurimit (procesi i gjashtë)*

8. Po kështu, në kuadër të detyrimit të përcaktuar nga neni 246, pika 6, i KPP-së, në datën 28.06.2024 Prokuroria e Posaçme ka informuar sërish gjykatën që ka caktuar masën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit për kërkuesin. Ky i fundit, në seancën gjyqësore të zhvilluar për çështjen, ka kërkuar revokimin e masës së sigurimit *"Arresti në shtëpi"*, duke pretenduar, ndër të tjera, se shkaku për të cilin ajo ishte marrë ishte i paligjshëm dhe nevojat e hetimit nuk e justifikonin vazhdimin e saj. Me vendimin nr. 400, datë 30.07.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vijimin e zbatimit të masës. Ky vendim është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 172 (87-2024-248), datë 13.09.2024, ndërsa me vendimin nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Në vijim, me vendimin nr. 3, datë 15.01.2026, Gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe deklarimin si antikushtetuese të vendimeve të gjykatave të zakonshme në pjesën që kanë disponuar për kërkuesin.

9. Sipas Gjykatës, shkaku për të cilin ndaj kërkuesit ishte vendosur masa e sigurimit me natyrë rënduese *"Arresti në shtëpi"* ishte i ndryshëm nga nevojat e sigurimit që kishin përligjur fillimisht caktimin e masave të sigurimit *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* dhe *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit"*. Ndërkohë, as organi i prokurorisë, as gjykatat e zakonshme nuk kishin parashtruar fakte ose rrethana konkrete, të ndodhura gjatë vijimit të hetimeve, që të justifikonin mbajtjen në fuqi të kësaj mase për shkak të rrezikut për marrjen ose vërtetësinë e provave apo të rrezikut të largimit të kërkuesit jashtë shtetit. Për këtë të fundit, Gjykata kishte vlerësuar më parë si joproporcionale masën *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit"*.

Në këtë situatë, Gjykata ka vlerësuar se pas 7 muajve nga fillimi i zbatimit të masës së sigurimit *"Arresti në shtëpi"*, të vendosur për shkak të mospërmbushjes nga kërkuesi të masës së sigurimit *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, vijimi i zbatimit të saj nuk ishte argumentuar në mbështetje të ndonjërës prej nevojave të sigurimit që mund të përligjnin mbajtjen në fuqi të saj. Në këto kushte, kjo masë ishte shndërruar praktikisht në një formë sanksioni penal, përtej natyrës dhe funksionit të masave të sigurimit personal.

- *Procesi objekt ankimi kushtetues individual (procesi i shtatë)*

10. Ndërkohë, Prokuroria e Posaçme ka përfunduar hetimet për çështjen, duke iu drejtuar në datën 10.10.2024 GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit dhe personave të tjerë. Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë paraprake, kërkuesi i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për revokimin e masës së sigurimit *"Arresti në shtëpi"*, kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. 674, datë 27.11.2024 *(vendimi nr. 674/2024)* të kësaj gjykate. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria e Posaçme, ndërsa kërkuesi apel kundërshtues.

11. Me vendimin nr. 1 (87-2025-1), datë 03.01.2025 *(vendimi nr. 1/2025)*, GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar kërkesën e kërkuesit për revokimin e masës *"Arresti në shtëpi"* dhe duke e zëvendësuar atë me masën "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji. Kërkuesi ka ushtruar rekurs në datën 05.03.2025, ndërsa në datat 01.04.2025 e 15.04.2025 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues të cilit i kishte kaluar çështja, duke pretenduar se i njëjti trup kishte shqyrtuar edhe 6 rekurse të tjera të paraqitura prej tij gjatë fazës së hetimit paraprak, si dhe se vendimi i GJKKO-së së Apelit ishte mbështetur në vendimin nr. 00-2024-1335, datë 16.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që kishte vendosur për të njëjtën çështje.

12. Me vendimet nr. 00-2025-621, datë 03.04.2025 dhe nr. 00-2025-714, datë 17.04.2025, gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Lartë ka deklaruar të papranueshme kërkesat e kërkuesit për përjashtimin e trupit gjykues të kësaj gjykate. Në vijim, me vendimin nr. 00-2025-658, datë 22.04.2025 *(vendimi nr. 658/2025)*, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Ky vendim u është komunikuar mbrojtësve të kërkuesit në datën 24.07.2025.

13. Në datën 20.11.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual kundër vendimeve gjyqësore të dhëna në procesin e mësipërm, duke pretenduar cenimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Në datën 21.01.2026 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *liria e lëvizjes*, e garantuar nga neni 38 i Kushtetutës dhe neni 2 i Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së:

A. Në aspektin procedural, në drejtim të:

14.1. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi *i)* në tejkalim të kompetencave të tij, gjyqtari i GJKKO-së së Apelit e ka gjykuar çështjen në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, ndonëse gjyqtari i shkallës së parë nuk e ka gjykuar në këtë cilësi, por si gjyqtar i gjykatës pranë së cilës ndodheshin aktet, sipas përcaktimeve të nenit 260, pika 4, fjalia e dytë, të KPP-së, ndërkohë që dosja hetimore me 333 fashikuj nuk ishte pjesë e dosjes për revokimin e masës. Edhe pse ka pranuar se gjyqtarët e GJKKO-së së Apelit nuk janë gjyqtarë të seancës paraprake, pasi çështja nuk ishte regjistruar ende në këtë gjykatë për shqyrtimin në atë fazë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjyqtari i GJKKO-së së Apelit ka cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, ndonëse ai nuk ishte vënë në lëvizje për shqyrtimin e çështjes në këtë fazë. Po kështu, *ii)* pa qenë kërkuar nga prokuroria caktimi i një mase konkrete sigurimi dhe pa pasur cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, gjyqtari i gjykatës së apelit ka rënduar pozitën juridike të kërkuesit, duke caktuar ndaj tij një masë sigurimi, duke disponuar tej kërkesës së prokurorisë dhe duke vlerësuar kryesisht nevojat e hetimit, ndonëse hetimet kishin përfunduar. Një veprim i tillë bie ndesh me nenin 425 të KPP-së, pasi gjykata duhej t'u përmbahej shkaqeve të ngritura në ankim nga prokuroria dhe kërkesës së kërkuesit për revokimin e masës. *iii)* Trupi gjykues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është caktuar me short, por është përcaktuar për shkak të pjesëmarrjes së tij në shqyrtimin e kërkesave të mëparshme të palëve gjatë hetimeve paraprake.

14.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi *i)* caktimi nga GJKKO-ja e Apelit i masës së sigurimit me argumentin e garantimit të nevojave të hetimit, pa shqyrtuar aktet e hetimit paraprak, të cilat i ishin dërguar për gjykim gjykatës së shkallës së parë, tregon se vendimmarrja e saj ka qenë e paragjykuar. *ii)* Vendimi i kundërshtuar i GJKKO-së së Apelit është mbështetur në një vendim të mëparshëm të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke bërë që, gjatë shqyrtimit të çështjes objekt ankimi kushtetues individual, anëtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë të vlerësonin vendimmarrjen e tyre të mëparshme. *iii)* Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë kanë

qenë në kushte papajtueshmërie, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrjet e mëparshme për 6 kërkesa të kërkuesit, në të cilat ishin vlerësuar nevojat e sigurimit. Për këtë arsye, ata nuk mund të shqyrtonin nevojat e sigurimit në një fazë tjetër të procesit penal.

14.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi qëndrimi i Gjykatës së Lartë për njohjen e kompetencës së gjyqtarit të GJKKO-së së Apelit për të vepruar në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake bie ndesh me qëndrimin e saj në vendimin nr. 00-2025-883, datë 29.05.2025, si dhe me vendimin e kësaj gjykate për rrëzimin e kërkesës së tij për përjashtimin e trupit gjykues.

14.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* të lidhur me *të drejtën e aksesit*, pasi *i)* konkluzioni i GJKKO-së së Apelit se kërkuesi nuk mund të qëndrojë pa masë sigurimi, për shkak se mund të ndikojë në kujtesën ose deklarimet e dëshmitarëve, nuk është mbështetur në analizën e provave, për sa kohë që kjo gjykatë nuk ka pasur në dispozicion aktet e dosjes penale, të cilat ndodheshin në gjykatën e shkallës së parë. *ii)* GJKKO-ja e Apelit nuk ka arsyetuar mjaftueshëm nevojën e caktimit të masës së sigurimit, në kushtet kur hetimet kishin përfunduar dhe prokuroria nuk kishte evidentuar një nevojë të tillë, as rrezikun e ndikimit të kërkuesit në marrjen ose vërtetësinë e provave të cituara në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. *iii)* Kjo gjykatë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se si masa e sigurimit *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* dy herë në muaj do të garantonte nevojat e sigurimit gjatë hetimit ose gjykimit, veçanërisht marrjen dhe vërtetësinë e provave me dëshmitarë. *iv)* Arsyetimi i GJKKO-së së Apelit se mjafton ankimi i organit të akuzës për rëndimin e pozitës së kërkuesit është në kundërshtim me nenet 244, 260 e 425 të KPP-së, sipas të cilave prokuroria është përgjegjëse për hetimin dhe përcaktimin e nevojave të sigurimit. Po kështu, është i pabazuar arsyetimi i kësaj gjykate se nevojat e sigurimit ishin verifikuar në një vendim të mëparshëm të GJKKO-së së Shkallës së Parë, pasi ai gjykim lidhej me nevojat e sigurimit gjatë hetimeve paraprake, ndërsa në momentin e paraqitjes së kërkesës për revokimin e masës, hetimet kishin përfunduar. GJKKO-ja e Apelit ka ngatërruar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale me ekzistencën e nevojave të sigurimit. *v)* Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor lidhur me kompetencat e gjyqtarit të GJKKO-së së Apelit. *vi)* Gjykata e Lartë nuk ka dhënë argumente të mjaftueshme për nevojën dhe proporcionalitetin e masës

në raport me fazën e procedimit penal, si dhe për mënyrën se si kjo masë do të garantonte marrjen e provave me dëshmitarë.

B. Në aspektin substancial

14.5. GJKKO-ja e Apelit është shprehur për rrezikun e ndikimit në procesin e të provuarit dhe atë të largimit e kërkuesit, ndërkohë që rrethi i provave është përcaktuar tashmë nga prokuroria, kurse rreziku i largimit nuk ekziston, duke pasur parasysh lidhjen e kërkuesit me Shqipërinë dhe faktin se është person i njohur publik, çka është pranuar edhe nga organi i prokurorisë në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të Kuvendit. GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë pranuar se nevojat e sigurimit nuk përligjin masën e sigurimit *"Arresti në shtëpi"* dhe se hetimet kanë përfunduar, ndërsa kanë vlerësuar se ndaj kërkuesit duhet të caktohet masa *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, me argumentin se provat formohen gjatë gjykimit dhe përfundimi i hetimeve nuk përjashton rrezikun e ndikimit të tij në provat me dëshmitarë.

14.6. Masa e sigurimit *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* cenon *parimin e proporcionalitetit*, pasi hetimet kanë përfunduar dhe qëndrimi i kërkuesit në gjendje të lirë nuk paraqet rrezik për marrjen e provave ose për largimin e tij për t'iu fshehur gjykimit. Gjykatat nuk kanë evidentuar nevojën për vijimin e masës së sigurimit në fazën konkrete të procedimit penal, as kanë shpjeguar se në ç'mënyrë paraqitja e tij në Policinë Gjyqësore garanton marrjen e provave. GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme për nevojën, domosdoshmërinë e përshtatshmërinë e masës *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*. Kjo masë nuk u ka shërbyer nevojave të sigurimit dhe ka marrë natyrë ndëshkuese.

15. ***Subjekti i interesuar***, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

A. Për aspektin procedural

15.1. Pretendimet për cenimin e *parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj* janë të pabazuara, pasi *i)* në kundërshtim nga sa pretendon kërkuesi, shprehja "nga gjykata ku ndodhen aktet" në nenin 260, pika 4, të KPP-së e përcakton kompetencën e gjykatës në varësi të fazës procedurale ku ndodhet çështja. Gjatë hetimeve paraprake kompetenca i përket gjyqtarit të hetimeve paraprake, pas përfundimit të tyre gjyqtarit të seancës paraprake dhe me

fillimin e shqyrtimit gjyqësor, gjykatës që shqyrton themelin e çështjes. Ndërsa neni 426/a, pika 5, i këtij kodi parashikon se në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë. Shprehja "gjykata ku ndodhen aktet" nuk nënkupton gjykatën ndodhen fizikisht aktet, por gjykatën kompetente. Në këtë kuptim, ankimet për masat e sigurimit mund të shqyrtohen nga çdo gjyqtar, duke pasur parasysh natyrën urgjente të tyre, për sa kohë që respektohen rregullat përkatëse. Zëvendësimi i masës së sigurimit mund të bëhet kryesisht nga gjykata kur vlerëson se nevojat e sigurimit janë zbutur ose masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Për më tepër, kërkuesi nuk ka pasur asnjë pengesë për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues të gjykatës së apelit. Po kështu, *ii)* shqyrtimi i çështjes është bërë nga gjykata e apelit brenda shkaqeve të ankimit. Në ankim organi i ndjekjes penale ka pretenduar ndryshimin e kushteve dhe rrethanave që përligjnin masën e sigurimit, si rrjedhojë e dërgimit të çështjes për gjykim dhe kalimit nga dyshimi i arsyeshëm në bindjen e organit të akuzës se kërkuesi e kishte kryer veprën penale, si dhe ekzistencën e rrezikut për marrjen dhe vërtetësinë e provave etj. Për më tepër, sipas nenit 249 të KPP-së, gjykata e apelit vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar në ankim ose që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit. Pra, ajo shqyrton çështjen në tërësi, pavarësisht arsyeve të parashtruara në ankim. Sipas neneve 244, pika 3, 260, pika 3, 425, pika 2, të KPP-së, gjykata e apelit nuk mund të caktojë një masë më të rëndë sigurimi se ajo e kërkuar nga prokurori, por këto dispozita nuk e pengojnë të caktojë një masë më të lehtë, për sa kohë në ankim kërkohet shfuqizimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, siç ka ndodhur në rastin konkret. *iii*) Pretendimet për trupin gjykues të Gjykatës së Lartë janë gjithashtu të pabazuara. Nenet 13, 14 e 14/a të KPP-së nuk bëjnë dallim ndërmjet gjyqtarëve të kësaj gjykate sipas fazave të procedimit penal, pasi ata janë gjyqtarë ligji. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ruajtja e një ndarjeje të tillë është e gabuar. Në këtë kuptim, fakti që i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar edhe më parë masat e sigurimit ndaj kërkuesit nuk i vendos gjyqtarët në kushte papajtueshmërie, për sa kohë që këto vendimmarrje nuk kanë të bëjnë me gjykimin në themel të çështjes. Gjyqtarët e vetëm të Gjykatës së Lartë kanë dhënë arsyetim të

mjaftueshëm për këto rrethana në vendimet e tyre për kërkesat e kërkuesit për përjashtimin e trupit gjykues të kësaj gjykate.

15.2. Pretendimet për cenimin e *parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme* janë të pabazuara, pasi *i)* gjyqtari i apelit vendos mbi bazën e akteve që ka shqyrtuar gjykata e shkallës së parë, përveç atyre që mund të merren në apel; *ii)* vendimmarrjet e mëparshme nuk kanë të bëjnë me shqyrtimin në themel të çështjes; *iii)* kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për shkaqet e rrëzimit të kërkesave të tij për përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

15.3. Pretendimet për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* janë të pabazuara, pasi vendimi nr. 00-2025-883, datë 29.05.2025, i Gjykatës së Lartë, të cilit kërkuesi i referohet, nuk është njësues dhe, për më tepër, nuk mbështet pretendimin e tij. Në këtë vendim Gjykata e Lartë ka vlerësuar se, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet çështja, një gjyqtar nuk ka pengesë ligjore për vijimin e shqyrtimit të ankimit, për sa kohë çështja i ka kaluar me short, sipas parashikimeve të nenit 37, shkronja "b", të ligjit nr. 98/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

15.4. Pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* në drejtim të *së drejtës së aksesit* janë të pabazuara, pasi GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të kërkuesit për përmbushjen e kushteve dhe kritereve për revokimin e masës së sigurimit, duke u mbështetur në të njëjtat akte dhe të dhëna që ka shqyrtuar edhe gjykata e shkallës së parë. Po kështu, kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë edhe për pretendimet për përbërjen e trupit gjykues të saj.

B. Për aspektin substancial

15.5. Pretendimet për *cenimin e lirisë së lëvizjes* janë të pabazuara, pasi kërkuesi ka qenë i lirë të lëvizë si brenda territorit të shtetit, ashtu edhe jashtë tij. Kërkuesi nuk ka kërkuar të jetojë në një vend tjetër nga ai ku banon aktualisht, si dhe është lejuar të marrë pjesë dhe ka marrë pjesë lirisht në veprimtari ndërkombëtare të zhvilluara jashtë territorit shqiptar.

15.6. Pretendimet për cenimin e *parimit të proporcionalitetit* janë të pabazuara, pasi kufizimi i lirisë së lëvizjes së kërkuesit përmes masës *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* i shërben interesit publik të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Kalimi i

çështjes për gjykim nuk e bën të panevojshëm vijimin e kësaj mase, pasi provat merren dhe formohen gjatë gjykimit, ndërsa gjykata ka të drejtë, edhe kryesisht, të kërkojë dhe të marrë prova. Pushteti i kërkuesit, lidhjet e tij familjare, të krushqisë ose të hershme me dëshmitarët dhe marrëdhëniet e varësisë ose politike që ka krijuar me këta të fundit përbëjnë rrethana që tregojnë ekzistencën e rrezikut të ndikimit të tij në marrjen ose vërtetësinë e provave, pra se ai mund të ndikojë në helmimin e tyre. Po kështu, rreziku i largimit nuk mund të konsiderohet i përjashtuar, pasi gjatë hetimeve ka rezultuar se kërkuesi disponon pasuri dhe mjete të mjaftueshme financiare që do t'i mundësonin jetesën edhe jashtë vendit. Familja e vajzës së tij disponon gjithashtu pasuri jashtë territorit shqiptar. Në këtë situatë, duke marrë parasysh edhe llojin e veprës penale, kryerjen e saj të dyshuar në formën e bashkëpunimit, shuma që pretendohet të jetë përfituar nga vepra penale, masën e dënimit që kërkuesi rrezikon nëse deklarohet fajtor, mundësinë e ndikimi i tij te dëshmitarët dhe personat e tretë, si dhe mosbindja ndaj vendimeve gjyqësore, masa *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* nuk rezulton joproporcionale. Në caktimin e kësaj mase është marrë parasysh edhe mosha e kërkuesit. Fakti që gjykata e shkallës së parë ka revokuar masën e caktuar më parë, duke përjashtuar rrezikun e largimit me arsyetimin se kërkuesi nuk është dënuar më parë, është deputet dhe aktiv në jetën politike, nuk mund të merret i mirëqenë *a priori*, pasi të pandehur të tjerë, me të njëjtat cilësi, i janë shmangur ndjekjes penale. Po ashtu, edhe kërkuesi u është shmangur oficerëve të policisë Gjyqësore kur ata kanë tentuar t'i njoftojnë vendimin fillestar për caktimin e masave të sigurimit *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* dhe *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit"*, përveçse nuk e ka zbatuar masën e parë, shkak për të cilin ajo më pas është zëvendësuar me masën "Arresti në shtëpi".

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

16. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës

private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme. Po ashtu, as subjekti i interesuar nuk ka ngritur ndonjë prapësim.

18. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte *(shih vendimet nr. 1, datë 17.01.2025; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese).*

19. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm, ndërkohë që ankimi kushtetues individual synon të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm. Bazuar në këtë qasje, Gjykata, në mënyrë përjashtimore, ka bërë pjesë të kontrollit kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen këto kritere: (i) vendimi duhet të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra cenimi i pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar ose, e thënë ndryshe, kërkuesi duhet të tregojë se është viktimë e cenimit të së drejtës kushtetuese; (ii) vendimi të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që, pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë *(shih vendimet nr. 42, datë 01.07.2025; nr. 22, datë 04.04.2024; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Në rastin e vendimeve me natyrë jo përfundimtare që jepen gjatë një procesi gjyqësor, Gjykata, bazuar në përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe

qëllimin e natyrën e ankimit kushtetues individual, ka vlerësuar nëse të tilla vendime, pavarësisht karakterit të tyre, janë, *së pari*, të afta të prekin të drejta themelore të individit dhe, *së dyti*, cenimi është në atë masë dhe formë që pasojat e ardhura janë të vështira ose të pamundura për t'u riparuar gjatë procesit të themelit *(shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese).* Mbështetur në këtë qasje, Gjykata ka pranuar se vendimet gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues që lidhen me heqjen e lirisë së individit, përjashtimisht, konsiderohen vendime përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 53, datë 28.04.2026; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Konkretisht, Gjykata ka konsideruar të tilla vendimet për caktimin e masave të sigurimit personal *"Arresti në burg" (shih vendimet nr. 40, datë 26.03.2026; nr. 83, datë 05.12.2024; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese),* si dhe *"Arresti në shtëpi" (shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata, gjithashtu, ka marrë në shqyrtim edhe vendimet gjyqësore të dhëna në lidhje me kërkesat për zëvendësimin e masave të sigurimit të lartpërmendura *(shih vendimet nr. 81, datë 02.07.2026; nr. 43, datë 31.03.2026; nr. 40, datë 14.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese)* dhe vendimet gjyqësore që kanë vlerësuar informacionin dymujor të prokurorisë, bazuar në nenin 246, pika 6, të KPP-së *(shih vendimet nr. 4 datë 15.01.2026; nr. 3, datë 15.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se ajo është vënë në lëvizje për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore që lidhen me caktimin ndaj kërkuesit të masës së sigurimit personal *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji. Duke qenë se këto vendime, për nga natyra e tyre, janë të ndërmjetme, për sa kohë janë dhënë në kuadër të një procedimi penal që është ende duke u zhvilluar, Gjykata do të ndalet në verifikimin e përmbushjes së kritereve të mësipërme, që lejojnë, përjashtimisht, ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj tyre.

22. Lidhur me kriterin e parë, Gjykata do të vlerësojë nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë vendosur mbi një të drejtë kushtetuese të kërkuesit dhe nëse cenimi i pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e tyre. Për këtë qëllim, ajo do të shqyrtojë natyrën e së drejtës së pretenduar të shkelur dhe ndikimin e vendimeve të kundërshtuara në ushtrimin e saj.

23. Për sa i përket së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, Gjykata vëren se kërkuesi i ka ngritur pretendimet e tij në këndvështrim të lirisë së lëvizjes, të garantuar nga neni 38 i Kushtetutës dhe neni 2 i Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Gjykata ka pasur edhe më parë në shqyrtim kërkesa që lidhen me vendimet gjyqësore për caktimin ose vijimin e masës së sigurimit personal *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, në të cilat kërkuesit kanë ngritur pretendime lidhur me (i) të drejtën për proces të rregullt ligjor (që lidheshin në

thelb me çështje të provueshmërisë së fajësisë, ekzistencës së elementeve të veprës penale dhe vlefshmërisë së akuzës), si dhe (ii) lirinë personale. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve Gjykata ka konstatuar, sipas rastit, se ato lidheshin në thelb me çështje që mund të shqyrtoheshin gjatë gjykimit penal të themelit ose se masa e kundërshtuar nuk sillte privim të lirisë personale. Për rrjedhojë, vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë konsideruar si jopërfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues *(shih vendimet nr. 195, datë 24.09.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; nr. 266, datë 27.07.2026 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese).*

24. Në ndryshim nga pretendimet e shqyrtuara më parë, në rastin konkret Gjykata evidenton se cenimi i pretenduar lidhet me ndikimin që zbatimi i masës së sigurimit sjell në ushtrimin e lirisë së lëvizjes së kërkuesit. Për rrjedhojë, për të përcaktuar nëse vendimet gjyqësore të ndërmjetme objekt shqyrtimi përfshihen në kontrollin kushtetues, Gjykata do të vlerësojë nëse ndërhyrja në lirinë e lëvizjes është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimeve të kundërshtuara dhe nëse plotësohen kriteret e tjera të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese *(shih paragrafin 19 të këtij vendimi).*

25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* ka mbajtur qëndrimin se detyrimi për t'u paraqitur ose për të raportuar periodikisht pranë autoriteteve policore përbën një formë kufizimi të lirisë së lëvizjes *(shih Timofeyev dhe Postupkin kundër Rusisë, datë 19.01.2021, §§ 125; De Tommaso kundër Italisë [DHM], datë 23.02.2017, §§ 17, 89; Villa kundër Italisë, datë 20.04.2010, §§ 14, 43; Poniński kundër Polonisë, datë 10.02.2000).* Bazuar në këtë qasje të GJEDNJ-së, Gjykata çmon se masa e sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, për nga natyra dhe përmbajtja e detyrimeve që imponon, përbën ndërhyrje në lirinë e lëvizjes së kërkuesit, pasi kufizon mundësinë e tij për të vendosur lirisht për lëvizjet, duke e detyruar atë të jetë i pranishëm në një vend dhe kohë të përcaktuar. Kjo ndërhyrje është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, të cilat përcaktojnë detyrimin e kërkuesit për t'u paraqitur dy herë në muaj në Policinë Gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në rastin konkret përmbushet kriteri i parë i përcaktuar nga jurisprudenca kushtetuese.

26. Po kështu, Gjykata evidenton se vendimi i GJKKO-së së Apelit, me të cilin është caktuar ndaj kërkuesit masa e sigurimit personal *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore",* është kundërshtuar prej tij me rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e tij. Në këto kushte, duke qenë se kërkuesi i ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion për kundërshtimin e vendimeve që kanë ndërhyrë në lirinë e tij të lëvizjes, Gjykata vlerëson se është përmbushur edhe kriteri i dytë.

27. Në lidhje me kriterin e tretë, Gjykata vëren se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë një masë autonomie nga procesi penal i themelit, pasi ndërhyrja në lirinë e lëvizjes që

rrjedh prej tyre prodhon efekte të drejtpërdrejta gjatë periudhës së zbatimit të masës së sigurimit. Në këtë kuptim, pavarësisht vendimmarrjes që do të jepet në përfundim të procesit penal, përfshirë edhe rastin e një vendimi pafajësie, ndërhyrja në lirinë e lëvizjes gjatë zbatimit të masës së sigurimit nuk mund të zhbëhet ose të riparohet në masën e duhur nga vendimi përfundimtar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, plotësohet edhe kriteri i tretë.

28. Në referim të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se vendimet gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, ndonëse kanë natyrë të ndërmjetme, ndërhyjnë drejtpërdrejt në lirinë e lëvizjes së kërkuesit, duke sjellë pasoja që nuk mund të riparohen në masën e duhur gjatë gjykimit të themelit. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë natyrën e së drejtës kushtetuese të pretenduar, pasojat e drejtpërdrejta të vendimeve të kundërshtuara, si dhe faktin se ato janë bërë objekt i mjeteve të ankimit të parashikuara nga ligji, në kuadër të të cilave kërkuesi ka ngritur pretendimet përkatëse lidhur me ligjshmërinë dhe nevojën e masës së sigurimit, Gjykata çmon se këto vendime konsiderohen përfundimtare në rastin konkret për qëllime të kontrollit kushtetues, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe 71/a, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Organik të Gjykatës, dhe se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

29. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae* në ankimin kushtetues individual, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e zakonshme i kanë cenuar *lirinë e lëvizjes* në aspektin procedural dhe atë substancial. Sipas tij, në aspektin procedural vendimet gjyqësore i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor* (në drejtim të *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit).* Ndërsa në aspektin substancial, kërkuesi ka pretenduar se liria e tij e lëvizjes është kufizuar në cenim edhe të *parimit të proporcionalitetit*. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se liria dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara garantohen nga nenet 38, 42, 4, 142, pika 1, dhe 17 të Kushtetutës, për rrjedhojë përfshihen në juridiksionin kushtetues.

30. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, me argumentin se qëndrimi i Gjykatës së Lartë për njohjen gjyqtarit të GJKKO-së së Apelit të kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake bie ndesh me qëndrimin e asaj gjykate në një tjetër çështje dhe me vendimin e saj që ka deklaruar të papranueshme kërkesën e dytë të kërkuesit për përjashtimin e trupit gjykues.

31. Subjekti i interesuar ka prapësuar se vendimi të cilit kërkuesi i referohet, nuk është njësues dhe, për më tepër, nuk mbështet pretendimin e tij, pasi në këtë vendim Gjykata e

Lartë ka vlerësuar se pavarësisht fazës në të cilën ndodhet çështja, një gjyqtar nuk ka pengesë ligjore për vijimin e shqyrtimit të ankimit, për sa kohë çështja i ka kaluar me short, sipas parashikimeve të nenit 37, shkronja "b", të ligjit nr. 98/2016.

32. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se zbatimi në mënyrë uniforme i ligjit, garantimin e të cilit, në instancë të fundit, Kushtetuta në nenin 141 ia ka ngarkuar në mënyrë të shprehur Gjykatës së Lartë, është një element thelbësor i parimit të barazisë përpara ligjit. Ky parim së bashku me atë të sigurisë juridike, ndërlidhen midis tyre dhe synojnë të garantojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Kjo do të thotë se individët kanë pritshmëri të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe mund t'u referohen vendimeve gjyqësore të mëparshme për raste të ngjashme, në mënyrë që të parashikojnë efektet juridike të veprimeve ose mosveprimeve të tyre *(shih vendimet nr. 83, datë 05.12.2024; nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po kështu, sipas Gjykatës, fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje ka veçoritë specifike dhe individualitetin e saj, të lidhura edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore konkrete, të cilat nuk mund të jenë të njëjta *(shih vendimet nr. 81, datë 02.07.2026; nr. 2, datë 14.01.2026; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

33. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vlerëson se referimi i kërkuesit te një vendimmarrje tjetër të Gjykatës së Lartë, në të cilën, sipas tij, është mbajtur një qëndrim i ndryshëm, nuk është, në vetvete, i mjaftueshëm për të mbështetur cenimin e parimit të sigurisë juridike, për sa kohë nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë bërë një interpretim unifikues ose njësues për kompetencën e gjyqtarit të GJKKO-së së Apelit në shqyrtimin e ankimeve ndaj masave të sigurimit pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancën paraprake. Gjykata mban parasysh edhe faktin se vendimi të cilit i referohet kërkuesi është dhënë në datën 29.05.2025, pra pas vendimit të kundërshtuar prej tij, të datës 22.04.2025, ndaj nuk mund të konsiderohet se Gjykata e Lartë, në çështjen e kërkuesit, ka devijuar nga një qëndrim i shprehur në një vendimmarrje të mëparshme. Për më tepër, në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi, qëndrimi i Gjykatës së Lartë në vendimin e referuar nuk rezulton të jetë në kundërshtim me atë të mbajtur në çështjen e tij. Konkretisht, në vendimin nr. 00-2025-883, datë 29.05.2025, Kolegji Penal i asaj gjykate ka vlerësuar se fillimi i shqyrtimit të themelit të çështjes nga gjykata e shkallës së parë nuk përbën pengesë ligjore për shqyrtimin e ankimeve për zëvendësimin e masës së sigurimit nga i njëjti gjyqtar i gjykatës së apelit që ka shqyrtuar kërkesat gjatë hetimeve paraprake, për sa kohë që çështja, si gjykim "themeli", nuk është regjistruar ende në gjykatën e shkallës së dytë *(gjykatën e apelit)* dhe nuk është konstituuar

ende trupi gjykues i kësaj të fundit. Po kështu, për sa i përket pretendimit për kontradiktën me vendimin që ka deklaruar të papranueshme kërkesën e dytë për përjashtimin e gjyqtarëve, Gjykata vëren se ai vendim ka pasur objekt vlerësimin e papajtueshmërisë së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për shkak të pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrjet e mëparshme, ndërsa në vendimin e kundërshtuar në procesin konkret është shqyrtuar kompetenca e gjyqtarit të GJKKO-së së Apelit për të vendosur për ankimin ndaj masës së sigurimit. Për rrjedhojë, këto vendimmarrje kanë trajtuar çështje të ndryshme dhe nuk rezultojnë të përmbajnë qëndrime kontradiktore që të vënë në dyshim respektimin e parimit të sigurisë juridike. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e këtij parimi është haptazi i pabazuar.

34. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumenti themelor i kërkuesit lidhet me faktin se masa e sigurimit personal *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* ndërhyn në lirinë e lëvizjes *(shih paragrafin 25 të vendimit),* pra me justifikimin e nevojës dhe proporcionalitetit të kësaj mase sigurimi nga gjykatat e zakonshme, çmon t'i shqyrtojë ato në drejtim të së drejtës substanciale të lirisë së lëvizjes, të garantuar nga neni 38 i Kushtetutës dhe neni 2 i Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, Gjykata sjell në vëmendje jurisprudencën e saj, sipas së cilës, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, ajo bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, pasi, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, u takon atyre gjykatave që krahas zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të marrin në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, ndërsa Gjykata ndërhyn si instanca e fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 33, datë 20.05.2025; nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë së lëvizjes të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

35. Kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë vlerësuar se ai duhet të vijojë të qëndrojë nën masën e sigurimit *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* dy herë në muaj, për shkak të rrezikut të ndikimit te dëshmitarët, ndonëse kanë pranuar se hetimet paraprake kanë përfunduar dhe provat janë përcaktuar tashmë nga prokuroria. Sipas tij, këto gjykata nuk kanë evidentuar rrethanat që justifikojnë nevojën për vazhdimin e masës në fazën konkrete të procedimit penal, si dhe nuk kanë shpjeguar në ç'mënyrë detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore garanton marrjen e provave, duke mos dhënë argumente të mjaftueshme për nevojën, domosdoshmërinë dhe dobishmërinë e masës. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar për rrezikun e largimit të tij, ndonëse ky rrezik ishte pranuar se nuk ekzistonte edhe nga Prokuroria e Posaçme. Për rrjedhojë, masa jo vetëm që nuk

u ka shërbyer nevojave të sigurimit, por ka marrë natyrë ndëshkuese. Po sipas kërkuesit, arsyetimi i GJKKO-së së Apelit se ankimi i prokurorisë ishte i mjaftueshëm për rëndimin e pozitës së tij është në kundërshtim me nenet 244, 260 dhe 425 të KPP-së, ndërsa referimi i kësaj gjykate në një vendimmarrje të mëparshme të GJKKO-së së Shkallës së Parë për ekzistencën e nevojave të sigurimit është i pabazuar, pasi ajo vendimmarrje lidhej me fazën e hetimeve paraprake.

36. Prokuroria e Posaçme i ka prapësuar si të pabazuara këto pretendime, me arsyetimin se kërkuesi ka qenë i lirë të lëvizë si brenda territorit të shtetit, ashtu edhe jashtë tij, si dhe se masa *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* i shërben interesit publik të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe zhvillimit të procesit të rregullt ligjor, për sa kohë që provat merren dhe formohen gjatë gjykimit dhe ekziston rreziku që kërkuesi të ndikojë në marrjen dhe vërtetësinë e tyre, si dhe të largohet. Fakti që gjykata e shkallës së parë ka revokuar masën e caktuar më parë, duke përjashtuar rrezikun e largimit me arsyetimin se kërkuesi nuk është dënuar më parë, është deputet dhe aktiv në jetën politike, nuk mund të merret i mirëqenë *a priori*, pasi të pandehur të tjerë, me të njëjtat cilësi, i janë shmangur ndjekjes penale. Sipas subjektit të interesuar, edhe kërkuesi u është shmangur oficerëve të Policisë Gjyqësore kur kanë tentuar t'i njoftojnë vendimin fillestar për caktimin e masave të sigurimit "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* dhe *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit",* përveçse nuk e ka zbatuar masën e parë, shkak për të cilin ajo më pas është zëvendësuar me masën "Arresti në shtëpi".

37. Kërkuesi ka prapësuar në vijim se pretendimet e Prokurorisë së Posaçme për rrezikun e largimit nuk janë parashtruar në gjykimet e mëparshme dhe se ato nuk kanë qenë objekt shqyrtimi gjyqësor. Po sipas tij, sjellja e subjekteve të tjera nuk përbën shkak faktik ose ligjor për të konkluduar se edhe ai do të ketë të njëjtën sjellje, pasi masat e sigurimit përcaktohen në bazë të vlerësimit të individualizuar të sjelljes së çdo personi ndaj të cilit procedohet.

38. Gjykata vëren se liria e lëvizjes garantohet nga neni 38, pika 1, i Kushtetutës, i cili parashikon se kushdo ka të drejtë të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit. Kjo e drejtë garantohet edhe nga neni 2 i Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, i cili parashikon, ndër të tjera, se kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të (*paragrafi 1*).

39. Në lidhje me përmbajtjen e kësaj lirie, Gjykata Kushtetuese italiane ka theksuar se ajo konsiston në mundësinë e individit për të vendosur në mënyrë autonome për lëvizjen e tij në hapësirë, duke zgjedhur me vullnetin e tij vendet ku lëviz dhe ku qëndron *(shih vendimet nr. 20, datë 24.02.2026; nr. 127, datë 26.05.2022, pika 3.1, të Gjykatës Kushtetuese italiane).*

Po kështu, ajo ka vlerësuar se liria e lëvizjes gëzon garanci kushtetuese që i përgjigjen rëndësisë së saj themelore, edhe për faktin se përbën bazën faktike për ushtrimin e shumë të drejtave të tjera me rëndësi parësore *(shih vendimin nr. 127, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese italiane).*

40. Referuar përmbajtjes së nenit 38 të Kushtetutës dhe standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se liria e lëvizjes në çdo pjesë të territorit garanton të drejtën themelore të individit për të përcaktuar në mënyrë autonome vendndodhjen e tij në hapësirë dhe në kohë, duke përfshirë të drejtën për të zgjedhur lirisht vendet ku dëshiron të ndodhet, për të lëvizur nga një vend në tjetrin, si dhe për të vendosur për momentin dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në një vend të caktuar. Në këtë kuptim, ajo mbron lirinë e individit për të vendosur vetë për lëvizjet e tij, pa ndërhyrje arbitrare të autoriteteve publike.

41. Gjykata vlerëson se liria e lëvizjes nuk është absolute. Sipas nenit 17 të Kushtetutës, kufizime të saj mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimet e kësaj lirie parashikohen edhe në nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, sipas të cilit ushtrimi i së drejtës së lëvizjes *nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve* (paragrafi 3). Po kështu, në të njëjtin nen parashikohet se të drejtat e parashikuara në paragrafin 1, *në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike* (paragrafi 4).

42. Në kuptim të sa më lart, masa e sigurimit personal *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, edhe pse nuk ndalon lëvizjen e lirë në pjesën tjetër të kohës dhe nuk përbën ndalim të daljes jashtë shtetit, sikurse u vlerësua më sipër *(shih paragrafin 25 të vendimit)*, përbën ndërhyrje në lirinë e lëvizjes së kërkuesit, për sa kohë që kufizon mundësinë e tij për të vendosur lirisht për lëvizjet e tij. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se prapësimi i subjektit të interesuar se kërkuesi është i lirë të lëvizë brenda dhe jashtë territorit nuk qëndron, pasi kjo rrethanë nuk përjashton ekzistencën e ndërhyrjes në të drejtën kushtetuese.

43. Në këto kushte, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse gjykatat e zakonshme kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë e lëvizjes përmes detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore dy herë në muaj, në përputhje me kriteret kushtetuese të përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, duke qenë se kërkuesi nuk kundërshton bazën ligjore të kësaj mase në vetvete dhe as ekzistencën e një interesi publik që mund të justifikojë vendosjen e saj, por pretendon se kufizimi konkret është joproporcional, Gjykata, bazuar në natyrën e pretendimeve të kërkuesit, do të analizojë nëse gjykatat e

zakonshme kanë dhënë arsye të mjaftueshme dhe konkrete për të justifikuar proporcionalitetin e ndërhyrjes, pra nevojën dhe përshtatshmërinë e masës së sigurimit.

44. Për sa i përket së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, duke përjashtuar çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 48, datë 22.09.2025; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjithsesi, zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimin nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në lidhje me masat e sigurimit personal, Gjykata vëren se nenet 232, pika 1, shkronja "b" dhe 234 të KPP-së kanë përcaktuar detyrimin për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore si një ndër masat shtrënguese të sigurimit, përmes së cilës gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të policisë gjyqësore dhe cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit. Ndërkohë, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së, masat e sigurimit personal vendosen: i) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që

duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; ii*)* kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; iii) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Neni 229 i KPP-së përcakton kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, duke kërkuar që ato të jenë të përshtatshme me nevojat e rastit, në përpjesëtim me rëndësinë e veprës penale dhe sanksionin përkatës. Po kështu, sipas nenit 260, pikat 2 dhe 3, të KPP-së, kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë, ndërsa kur nevojat e sigurimit rëndohen ose personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase shtrënguese ose ndaluese shtesë.

47. Në këtë drejtim, Gjykata sjell në vëmendje jurisprudencën e saj në lidhje me garantimin e lirisë personale, sipas të cilës kushtet, kriteret dhe procedurat gjyqësore për rivlerësimin, zëvendësimin dhe revokimin e masave të sigurimit ndikojnë drejtpërdrejt në këtë liri *(shih vendimet nr. 81, datë 02.07.2026; nr. 41, datë 26.03.2026; nr. 51, datë 18.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese),* prandaj ato (masat e sigurimit personal) mund dhe duhet të ndryshohen, duke u zëvendësuar me masa më të lehta ose më të rënda, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistonin në momentin e caktimit të tyre *(shih vendimet nr. 41, datë 26.03.2026; nr. 40, datë 14.05.2024; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë drejtim, prokuroria duhet të tregojë se ka vepruar me kujdesin e nevojshëm dhe pa vonesa të pajustifikuara në kryerjen e veprimeve hetimore ose procedurale, ndërsa gjykata duhet të verifikojë, në mënyrë të pavarur dhe të individualizuar, nëse arsyet e paraqitura për mbajtjen e personit nën masën e sigurimit mbeten konkrete, të rëndësishme, të mjaftueshme dhe të domosdoshme. Po ashtu, gjykata duhet të shqyrtojë nëse, me kalimin e kohës, nevojat e sigurimit që kanë përligjur fillimisht masën vazhdojnë të jenë reale dhe aktuale, si dhe nëse ato mund të garantohen nëpërmjet masave të tjera më të lehta të sigurimit. Kjo analizë duhet të zhvillohet në mënyrë të individualizuar, duke iu përgjigjur fakteve dhe rrethanave specifike të rastit konkret, pa e zhvendosur barrën te personi ndaj të cilit është caktuar masa. Kjo nuk përjashton detyrimin e këtij të fundit për t'ua bëjë të ditura organeve proceduese rrethanat që zbusin nevojat e sigurimit, në përputhje me nenin 260 të KPP-së *(shih vendimet nr. 81, datë 02.07.2026; nr. 43, datë 31.03.2026; nr. 41, datë 26.03.2026 të Gjykatës Kushtetuese).*

48. Gjykata vëren se ndonëse standardet e mësipërme janë zhvilluar në jurisprudencën kushtetuese në lidhje me masat e sigurimit që sjellin heqjen e lirisë personale, kërkesa që masa e sigurimit personal të mbështetet në nevoja konkrete dhe aktuale të sigurimit, si dhe të mbetet proporcionale gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, gjen zbatim *mutatis mutandis* edhe për masat që

kufizojnë lirinë e lëvizjes, duke mbajtur parasysh natyrën dhe shkallën e ndërhyrjes që ato sjellin në këtë liri.

49. Edhe sipas GJEDNJ-së, masa që kufizon lirinë e lëvizjes, e cila mund të ketë qenë e justifikuar fillimisht, mund të bëhet joproporcionale me kalimin e kohës, ndaj autoritetet kanë detyrimin të rivlerësojnë periodikisht dhe në mënyrë reale nevojën për vazhdimin e saj, duke marrë parasysh rrethanat individuale *(shih Földes dhe Földesné Hajlik kundër Hungarisë, datë 31.10.2006, §§ 32, 35-36; Riener kundër Bullgarisë, datë 23.05.2006, §§, 124 128)*. Një rivlerësim i tillë, i cili si rregull duhet të kryhet të paktën në shkallën e fundit nga gjykatat, pasi ato ofrojnë garancitë më të mira për pavarësinë, paanshmërinë dhe ligjshmërinë e procedurave, duhet të marrë në konsideratë të gjithë faktorët përkatës, përfshirë edhe ato që lidhen me proporcionalitetin e masës kufizuese *(shih Gochev kundër Bullgarisë, datë 26.11.2009, § 50).*

50. Në kuadër të standardeve të mësipërme, Gjykata, në rastin konkret, do të analizojë nevojën dhe përshtatshmërinë e kufizimit të lirisë së lëvizjes së kërkuesit, duke u mbështetur në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijues të KPP-së. Në këtë kontekst dhe në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata rithekson se u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që krahas zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, ndërsa juridiksioni kushtetues përbën instancën e fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave *(shih vendimet nr. 1, datë 17.01.2025; nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

51. Gjykata vëren se në kuadër të procedimit penal nr. 287/2020, së bashku me masën *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit"*, në zbatim të neneve 228 e vijues të KPP-së dhe në cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", ndaj kërkuesit është caktuar fillimisht edhe masa *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*. Ndërsa vendimet për caktimin e masës së parë janë shfuqizuar me vendimin nr. 81/2024 të Gjykatës *(shih paragrafin 3 të vendimit)*, masa e dytë është zëvendësuar me masën *"Arresti në shtëpi"*, bazuar në nenin 260, pika 3, të KPP-së, për shkak të shkeljes nga kërkuesi të detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Në vijim, me vendimin nr. 3/2026, Gjykata ka deklaruar antikushtetuese vendimet gjyqësore për vazhdimin e zbatimit të masës *"Arresti në shtëpi" (shih paragrafët 8–9 të vendimit).* Ndërkohë, gjatë kohës që procesi për vazhdimin e kësaj mase ishte për shqyrtim në Gjykatë, masa *"Arresti në shtëpi"* është revokuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 674/2024, të kundërshtuar në procesin objekt ankimi kushtetues individual. Ky vendim është ndryshuar më pas nga GJKKO-ja e Apelit mbi bazën e ankimit të prokurorisë,

duke u zëvendësuar masa me atë *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

52. Në lidhje me vendimmarrjet objekt të shqyrtimit kushtetues, Gjykata evidenton se, bazuar në analizën e neneve 228-230 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar të bazuar kërkesën e kërkuesit për revokimin e masës *"Arresti në shtëpi"*, me arsyetimin se, edhe pse komunikimi i akuzës, përfundimi i hetimeve dhe dërgimi i çështjes për gjykim nuk kishin sjellë zbutjen e rrethanave dhe dyshimi për kryerjen e veprës vijonte të ekzistonte, ndaj kërkuesit nuk ishte evidentuar kryerja e veprave të tjera penale ose më të rënda, çka tregonte se nuk kishte as rëndim të pozitës së tij. Po sipas gjykatës, pavarësisht rrezikshmërisë shoqërore të veprës për të cilën akuzohej e marzhit të dënimit prej 4-12 vjetësh, nuk ekzistonte rreziku që kërkuesi të largohej, pasi nuk rezultonte që ai të ishte larguar nga vendi dhe nuk kishte të dhëna se prej vitit 2020, kur ishte regjistruar procedimi penal dhe kishin filluar hetimet, të kishte dashur ose të kishte tentuar të arratisej. Po kështu, sipas gjykatës, caktimi i masës *"Arresti në shtëpi"*, për shkak të mosrespektimit të detyrimit për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, nuk përbënte shkak për të konkluduar për ekzistencën e rrezikut të largimit si rrjedhojë e një dënimi të mundshëm, nëse në përfundim do të konkludohej me vendim fajësie.

53. Po sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, neni 245, pika 1, shkronja "d", i KPP-së kërkonte që në rastet kur masa e sigurimit vendosej për garantimin e marrjes ose vërtetësisë së provës, sipas nenit 228, pika 3, shkronja "a", të këtij kodi, në vendimin e masës të caktohej edhe një afat për kohëzgjatjen e saj, duke qenë se organi i akuzës është një strukturë shtetërore e mirëpërgatitur, që disponon të gjitha mekanizmat e nevojshëm për mbledhjen e provave, ndërsa përballë tij qëndron individi që prezumohet i pafajshëm. Sipas gjykatës, me përfundimin e hetimeve dhe dërgimin e çështjes në gjyq, rreziku për marrjen e provës zvogëlohet ndjeshëm, pasi organi i akuzës ka marrë dhe fiksuar të gjitha provat e nevojshme, duke i njoftuar akuzën të pandehurit dhe duke përfunduar hetimet, pavarësisht parashikimeve të nenit 332/c të KPP-së. Në këtë këndvështrim, në rastin e kërkuesit rreziku i dëmtimit të provave nuk ekzistonte, pasi, sipas nenit 331, pika 3, të KPP-së, kërkesa e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq përmbante burimin e provave dhe faktet të cilave ato u referoheshin, çka tregonte se, me përfundimin e hetimeve dhe dërgimin e çështjes në gjyq, organi i akuzës kishte fiksuar provat e nevojshme dhe nuk rezultonte që gjatë hetimeve paraprake të ishte ndeshur me vështirësi për mbledhjen e tyre ose të kishte kërkuar sigurimin e tyre sipas nenit 316 të KPP-së. Ndërkohë, nevoja për caktimin e masës për shkak të ekzistencës së rrezikut që kërkuesi të kryente krime të rënda ose të njëjta me atë për të cilin po procedohej, nuk kishte ekzistuar ndonjëherë. Në këtë situatë, duke mbajtur në konsideratë shtrirjen në kohë të hetimeve, llojin e provave të mbledhura dhe të kërkuara, mundësinë reale që kërkuesi të ndikonte në to, moshën dhe

personalitetin e tij, lidhjen e vazhdueshme dhe të pandërprerë me Shqipërinë, qenien e tij deputet dhe vijimin e aktivitetit politik e publik, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit që përligjnin masën e caktuar nuk ishin më prezente *(shih vendimin nr. 674/2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, faqet 56-62).*

54. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë ishte rrjedhojë e zbatimit të gabuar të KPP-së për sa i përket rrezikut të dëmtimit të provave, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk kishte marrë në konsideratë vendimin unifikues nr. 7/2011 për mundësinë e ndikimit në vërtetësinë e tyre edhe gjatë gjykimit. Sipas GJKKO-së së Apelit, provat formësohen ekskluzivisht gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe me kalimin e një kohe të gjatë nga momenti i ndodhjes së faktit ose rrethanës apo nën ndikimin e faktorëve të brendshëm ose të jashtëm, provat e gjalla me dëshmitarë, në ndryshim nga provat e ngrira shkresore, rrezikonin të humbisnin aftësinë për të riprodhuar të dhënën. Parashikimi nga organi i akuzës i çdo prove që mund të rrezikohej nga kërkuesi ishte praktikisht i pamundur, duke mbajtur në konsideratë se prokuroria kishte kërkuar pyetjen e 137 dëshmitarëve dhe të 5 bashkëpandehurve të tjerë, çështja ishte dinamike, komplekse, me material të konsiderueshëm provues dhe se hetimet u referoheshin edhe të dhëna të tjera që, gjithashtu, duheshin administruar, çka bënte praktikisht të pamundur që organi i akuzës të kërkonte sigurimin e tyre ose caktimin me afat të masës së sigurimit. Vlerësimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë për mungesën e rrezikut të ndikimi në prova ishte i pabazuar edhe për shkak të deklarimeve publike hapur agresive e kërcënuese ndaj prokurorisë e gjykatës, përmes të cilave kërkuesi vazhdonte të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë te dëshmitarët e thirrur në gjykim nga prokuroria.

55. Gjithashtu, GJKKO-ja e Apelit, ndërsa ka vënë në dukje se rreziku që kërkuesi të kryente vepra të tjera penale nuk ishte përdorur si argument për caktimin e masës, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk kishte paraqitur asnjë element të ri për të konkluduar mungesën e largimit, në raport me vendimmarrjet e mëparshme. Sipas saj, vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë cenonte parimin *res judicata*, pasi në analizën e rrezikut të largimit ajo nuk ishte bazuar në elemente ose rrethana të reja, por në të njëjtat rrethana mbi të cilat masa e sigurimit *"Arresti në shtëpi"* ishte caktuar për herë të parë ndaj kërkuesit. Sipas GJKKO-së së Apelit, gjykata e shkallës së parë kishte vepruar si gjykatë e shkallës së katërt, duke shpërfillur vendimmarrjet e mëparshme për caktimin e masës, si dhe vendimet e GJKKO-së së Apelit dhe Gjykatës së Lartë që kishin konfirmuar masën "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, e cila, sipas saj, ishte vlerësuar si proporcionale nga Gjykata. Po sipas GJKKO-së së Apelit, ndërsa me kalimin e një kohe të gjatë nën një masë të caktuar sigurimi dhe në rrethanat e mungesës së progresit të hetimeve, zbutja e nevojave të sigurimit mund të shërbejë si shkak për zëvendësimin e masës, ajo kurrsesi nuk mund të shërbejë për revokimin

e saj. Revokimi mund të vendoset vetëm nëse dalin ose zbulohen rrethana të reja, të cilat veçmas ose së bashku me ato të vlerësuara në caktimin e masës, bindin gjyqtarin se kushtet në fjalë nuk kanë ekzistuar që në momentin e caktimit të saj ose janë shuar më pas.

56. Në përfundim të gjykimit, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se kërkimi i kërkuesit për revokimin e masës "Arresti në shtëpi" duhej rrëzuar. Megjithatë, sipas saj, qëndrimi i tij për gati një vit nën masën e sigurimit "*Arresti në shtëpi"*, rënia e pretendimit të tij për antikushtetutshmërinë e masës *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* pas dhënies së vendimit nr. 81/2024 të Gjykatës, si dhe fakti që provat shkresore, të cilat përbënin pjesën më të madhe dhe kryesore të materialit provues, tashmë ishin marrë dhe administruar, tregonin se nevojat e sigurimit ishin zbutur. Për rrjedhojë, sipas saj, këto rrethana përligjnin zëvendësimin e masës *"Arresti në shtëpi"* me masën *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" (shih vendimin nr. 1/2025 të GJKKO-së së Apelit, faqet 15-22).*

57. Vendimi i GJKKO-së së Apelit është vlerësuar i drejtë nga Gjykata e Lartë, si për sa i përket përfundimit se GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk kishte argumentuar mungesën e nevojave të sigurimit mbi baza të reja faktike në raport me vendimmarrjet e mëparshme të tri shkallëve të gjyqësorit që përbënin *res judicata,* ashtu edhe për sa i përket rrëzimit të kërkesës së kërkuesit për revokimin e masës "*Arresti në shtëpi"* dhe ekzistencës së kushteve për zëvendësimin *in melius* të saj. Sipas Gjykatës së Lartë, zbutja e nevojave të sigurimit passillte mundësinë e zëvendësimit të masës, por jo të revokimit të saj. Kjo pasi verifikimi i nevojave të sigurimit kërkon vlerësimin e konceptit juridik të "rrezikut", pra të probabilitetit ose të mundësisë reale të vënies në rrezik të procesit të të provuarit apo të largimit të të pandehurit. Kjo gjendje "rreziku" dhe përfundimi i gjykatës lidhur me të përcaktohet në bazë të rrethanave të fakti dhe ligjit, të cilat vlerësohen rast pas rasti. Në rastin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit kishte vlerësuar nevojat e sigurimit jo vetëm në drejtim të shkeljeve të mëparshme prej tij të masave të sigurimit, por edhe në raport me ushtrimin e ndjekjes penale si shprehje e interesit publik dhe funksionet e kërkuesit në organizimin e fushatës elektorale, si kryetar i partisë opozitare në vend. Ajo kishte konkluduar se nevojat fillestare të sigurimit vijonin të ekzistonin për sa i përket garantimit të marrjes ose vërtetësisë së provës dhe rrezikut që kërkuesi të largohej. Ndërkohë, nisur nga fakti që masa ishte zëvendësuar *in melius*, pavarësisht se për kërkuesin vijonin të ekzistonin kushtet e përcaktuara nga neni 228, pika 3, shkronjat "a" e "b", të KPP-së dhe nevoja për të siguruar mbarëvajtjen e procedimit penal, në mungesë të një reagimi procedural të prokurorisë, shkaqet e evidentuara në rekurs për masën e zëvendësuar nuk ishin të tilla që cenonin vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit. Në kushtet e një interpretimi përfundimtar dhe autoritativ nga Gjykata për imunitetin e deputetit në raport me masat e sigurimit, kërkuesit duhej t'i jepej edhe një herë mundësia për të respektuar me

vullnetin e tij masën e sigurimit *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, proporcionaliteti i së cilës, siç kishte arsyetuar edhe GJKKO-ja e Apelit, ishte konfirmuar me vendimin nr. 81/2024 të Gjykatës *(shih vendimin e Gjykatës së Lartë, faqet 26-28).*

58. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Gjykata vëren se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë mbështetur nevojën për mbajtjen e kërkuesit nën masën *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* në ekzistencën e rrezikut për marrjen ose vërtetësinë e provave, si dhe të rrezikut të largimit, sipas nenit 228, pika 3, shkronjat "a" dhe "b", të KPP-së. Në këtë pikë, Gjykata thekson se përfundimi i hetimeve paraprake nuk sjell automatikisht shuarjen e nevojave të sigurimit, pasi rreziku për marrjen ose vërtetësinë e provave mund, në varësi të rrethanave konkrete, të vijojë edhe gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë kuptim, konstatohet se GJKKO-ja e Apelit, në caktimin e masës së re të sigurimit, ka marrë në konsideratë numrin e dëshmitarëve të kërkuar për t'u pyetur në gjykim, kompleksitetin e çështjes, si dhe deklarimet publike të kërkuesit, të cilat i ka vlerësuar si tregues të rrezikut të ndikimit te dëshmitarët.

59. Pavarësisht këtyre rrethanave, Gjykata vlerëson se GJKKO-ja e Apelit nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme lidhjen ndërmjet rrezikut të identifikuar dhe masës konkrete të zgjedhur për ta parandaluar atë. Në veçanti, për sa kohë që masa e detyrimit për t'u paraqitur dy herë në muaj në Policinë Gjyqësore nuk ndalon kontaktin me dëshmitarët dhe as lëvizjen e kërkuesit jashtë ditëve të caktuara për paraqitje, nuk rezulton të jetë arsyetuar në ç'mënyrë kjo masë ishte e përshtatshme për të parandaluar rrezikun e ndikimit në marrjen ose vërtetësinë e provave dhe përse ishte e nevojshme për garantimin e tyre. Po kështu, për sa i përket rrezikut të largimit, Gjykata vëren se GJKKO-ja e Apelit është mbështetur kryesisht në vendimmarrjet e mëparshme dhe mungesën e rrethanave të reja që përligjnin revokimin e masës, pa argumentuar mjaftueshëm nëse ky rrezik vijonte të ishte konkret dhe aktual në momentin e shqyrtimit të çështjes dhe në ç'mënyrë masa e zgjedhur i përgjigjej atij. Për rrjedhojë, ndonëse GJKKO-ja e Apelit ka identifikuar nevojat e sigurimit që, sipas saj, vijonin të ekzistonin, ajo nuk ka dhënë arsye konkrete dhe të mjaftueshme për të justifikuar nevojën dhe përshtatshmërinë e masës së zgjedhur, në raport me rrezikun për marrjen ose vërtetësinë e provave dhe atë të largimit të kërkuesit.

60. Gjithashtu, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë, ndonëse ka pranuar përfundimin e GJKKO-së së Apelit për vijimin e nevojave të sigurimit dhe zbutjen e tyre, është mjaftuar me vlerësimin se masa e sigurimit ishte zëvendësuar me një masë më të lehtë, pa analizuar në mënyrë të mjaftueshme nëse detyrimi për t'u paraqitur dy herë në muaj në Policinë Gjyqësore ishte i nevojshëm dhe i përshtatshëm për të parandaluar rrezikun e ndikimit në marrjen ose vërtetësinë e provave dhe atë të largimit të kërkuesit. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk i ka

kthyer përgjigje të mjaftueshme pretendimit të kërkuesit për cenimin e lirisë së lëvizjes në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit, ndonëse, duke pasur parasysh natyrën kushtetuese të këtij pretendimi, në zbatim të parimit të subsidiaritetit i takonte të vlerësonte nëse GJKKO-ja e Apelit kishte dhënë arsye konkrete dhe të mjaftueshme për nevojën dhe përshtatshmërinë e masës së caktuar ndaj kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë së lëvizjes i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

61. Në kushtet kur, për arsyet e mësipërme, çështja duhet të shqyrtohet sërish nga Gjykata e Lartë, Gjykata, në respektim të parimit të subsidiaritetit, çmon të mos ndalet në analizimin e mëtejshëm të pretendimeve të tjera të kërkuesit për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme.*

C. Për shpenzimet e përfaqësimit në Gjykatën Kushtetuese

62. Gjykata vëren se në datën 27.02.2026, përpara shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për mbulimin e shpenzimeve të gjykimit kushtetues. Sipas tij, mbrojtja juridike ka qenë e domosdoshme, për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe natyrës së saj. Për këtë qëllim, kërkuesi ka paraqitur faturën e datës 08.12.2025 të lëshuar nga avokatja Klodiana Gjyzari, në vlerën 200.000 lekë (pa TVSH), të përshkruar si pagesë për ofrimin e shërbimit të përfaqësimit në Gjykatë.

63. Neni 28 i Ligjit Organik ka parashikuar rregullat për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (*pika 1*); kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit me paraqitjen e kërkesës paraqitet edhe akti që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (*pika 2*); kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (*pika 4*).

64. Gjykata ka pohuar se individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, numrin e pretendimeve të pranuara nga Gjykata, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën

e kërkuar (*shih vendimet nr. 57, datë 14.10.2025; nr. 54, datë 09.10.2025; nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi është përfaqësuar nga e njëjta avokate që në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual fillestar (20.11.2025). Pasi çështja ka kaluar në seancë plenare dhe kërkuesi është njoftuar për të drejtën e paraqitjes së pretendimeve shtesë, përfaqësuesja e tij ligjore, në datën 27.02.2026, ka paraqitur së bashku me parashtrimet edhe faturën tatimore elektronike të lëshuar në datën 08.12.2025, në vlerën 200.000 lekë, për shpenzimet e përfaqësimit në Gjykatë.

66. Për sa më lart, Gjykata çmon se kërkimi i kërkuesit për shpenzimet gjyqësore është paraqitur brenda afatit, pasi ai është depozituar përpara përfundimit të shqyrtimit të çështjes në seancë plenare. Në lidhje me masën e shpenzimeve, Gjykata merr në konsideratë se ndonëse kërkuesi ka paraqitur faturën tatimore për shërbimin e përfaqësimit, ai nuk ka parashtruar ndonjë argument mbështetës që të justifikojë vlerën e kërkuar prej 200.000 lekësh. Nga ana tjetër, Gjykata mban parasysh se gjykimi kushtetues është zhvilluar mbi bazë të dokumenteve, dhe duke marrë në konsideratë numrin e pretendimeve të pranuara, si dhe kompleksitetin e çështjes dhe natyrën e shërbimit juridik të dokumentuar, vlerëson të arsyeshme shpenzimet e përfaqësimit në vlerën 60.000 lekë. Gjithashtu, në kushtet kur në gjykimin kushtetues individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, ndaj përgjegjësia i takon vetë shtetit *(shih vendimet nr. 74, datë 16.06.2026; nr. 54, datë 09.10.2025; nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese),* Gjykata vlerëson se detyrimi për pagimin e shpenzimeve të përfaqësimit duhet t'i ngarkohet Ministrisë së Financave.

67. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të pranohet pjesërisht sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-658, datë 22.04.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

4. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 60.000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 09.10.2026

Shpallur më 17.11.2026

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesi Sali Berisha, ndonëse bashkohem me përfundimin e shumicës për cenimin e lirisë së lëvizjes të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, mbaj qëndrim të ndryshëm në lidhje me argumentet mbi të cilat është mbështetur ky përfundim. Në vlerësimin tim, në rastin konkret, cenimi i lirisë së lëvizjes nuk lidhet vetëm me pamjaftueshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, por edhe me joproporcionalitetin e masës së sigurimit të caktuar nga GJKKO-ja e Apelit, në raport me rrethanat konkrete të çështjes dhe fazën në të cilën ndodhej procedimi penal.

2. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 674/2024, ka vendosur revokimin e masës së sigurimit *"Arresti në shtëpi"*, duke vlerësuar se nevojat e sigurimit nuk vijonin të ekzistonin. Në këtë drejtim, ajo ka mbajtur parasysh, ndër të tjera, përfundimin e hetimeve paraprake dhe dërgimin e çështjes për gjykim, administrimin e provave nga organi i akuzës, mungesën e të dhënave për përpjekje të kërkuesit për t'u larguar nga vendi, si dhe rrethanat e tij personale. Në vijim, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 1/2025, ka vlerësuar se nevojat e sigurimit vijonin të ekzistonin, por ishin zbutur, duke vendosur zëvendësimin e masës *"Arresti në shtëpi"* me masën *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, dy herë në muaj. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-658, datë 22.04.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke pranuar përfundimet e gjykatës së apelit për vijimin e nevojave të sigurimit dhe zbutjen e tyre.

3. Shumica, në analizën e pretendimit për cenimin e lirisë së lëvizjes, ka vlerësuar se GJKKO-ja e Apelit, ndonëse kishte identifikuar nevojat e sigurimit që vijonin të ekzistonin, nuk kishte dhënë arsye konkrete dhe të mjaftueshme për të justifikuar nevojën dhe përshtatshmërinë e masës së zgjedhur, në raport me rrezikun për marrjen ose vërtetësinë e provave dhe atë të largimit të kërkuesit. Po kështu, shumica ka konstatuar se Gjykata e Lartë nuk i kishte kthyer përgjigje të mjaftueshme pretendimit të kërkuesit për cenimin e lirisë së lëvizjes në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit. Për rrjedhojë, ajo ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë së lëvizjes të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor ishte i bazuar (*shih paragrafët 59-60 të vendimit*).

4. Në vlerësimin tim, në rastin konkret, rëndësi të veçantë merr fakti se masa e sigurimit është caktuar në një fazë të procedimit penal kur hetimet paraprake kishin përfunduar dhe çështja ishte dërguar për gjykim. Ndonëse përfundimi i hetimeve paraprake nuk passjell automatikisht shuarjen e nevojave të sigurimit, kjo rrethanë ka rëndësi për vlerësimin e proporcionalitetit të kufizimit të lirisë së lëvizjes, pasi kërkon që nevoja për vijimin e masës të shqyrtohet në raport me gjendjen konkrete të procedimit dhe rreziqet që mund të ekzistojnë në atë fazë.

5. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar edhe më parë se vijimi i zbatimit të një mase sigurimi nuk mund të justifikohet vetëm me shkaqet që kanë përligjur caktimin e saj fillimisht, pa u arsyetuar konkretisht ekzistenca e nevojave të sigurimit në raport me rrethanat aktuale të çështjes. Në veçanti, në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së vijimit të masës së sigurimit *"Arresti në shtëpi"* ndaj të njëjtit kërkues, Gjykata ka vlerësuar se mbështetja në të njëjtat shkaqe që kanë diktuar caktimin e masës, pa justifikuar konkretisht nevojën për vijimin e saj, kanë sjellë një kufizim joproporcional të lirisë personale (*shih vendimin nr. 3, datë 15.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse në rastin konkret bëhet fjalë për një masë sigurimi me natyrë dhe intensitet të ndryshëm kufizues, vlerësoj se edhe proporcionaliteti i kufizimit të lirisë së lëvizjes kërkon që gjykatat të verifikojnë nëse rrethanat që kanë përligjur caktimin e masës vijojnë të justifikojnë mbajtjen e saj në fuqi, duke marrë në konsideratë ndryshimet e ndodhura gjatë procedimit penal.

6. Duke iu kthyer rastit konkret, konstatohet se GJKKO-ja e Apelit, në vlerësimin e vijimit të nevojave të sigurimit, iu është referuar vendimmarrjeve të mëparshme gjyqësore, duke konsideruar se vlerësimet e bëra në to për ekzistencën e këtyre nevojave përbënin *res judicata* dhe se revokimi i masës kërkonte ekzistencën e rrethanave të reja. Në vlerësimin tim, një qasje e tillë nuk pajtohet me natyrën e masave të sigurimit personal dhe detyrimin e gjykatave për të verifikuar vijimin e kushteve dhe kritereve që përligjin zbatimin e tyre. Efektet e vendimmarrjeve të mëparshme për masat e sigurimit nuk mund të shtrihen deri në atë masë

sa të përjashtojnë detyrimin e gjykatës për të rivlerësuar ekzistencën e nevojave të sigurimit në raport me rrethanat aktuale të çështjes. Në rastin konkret, rëndësi merr edhe fakti se masa *"Arresti në shtëpi"* ishte caktuar si pasojë e mosrespektimit nga kërkuesi të masës fillestare *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, ndërsa në momentin e shqyrtimit të kërkesës për revokim gjykata duhej të vlerësonte nëse ekzistonin ende nevoja konkrete që justifikonin mbajtjen e tij nën një masë sigurimi. Për rrjedhojë, referimi te vendimmarrjet e mëparshme, duke u njohur atyre efekte që pengonin një rivlerësim të plotë të rrethanave aktuale, nuk mund të shërbente si bazë e mjaftueshme për vijimin e kufizimit të lirisë së lëvizjes.

7. Po kështu, vlerësoj se rrethanat mbi të cilat GJKKO-ja e Apelit ka mbështetur vijimin e nevojave të sigurimit nuk justifikonin, në mënyrë konkrete, proporcionalitetin e masës së caktuar. Ndonëse gjykata e apelit i është referuar numrit të dëshmitarëve që do të pyeteshin gjatë gjykimit, kompleksitetit të çështjes dhe deklarimeve publike të kërkuesit, nuk rezulton të ketë argumentuar në mënyrë të mjaftueshme se në çfarë mënyre këto rrethana dëshmonin ekzistencën e një rreziku konkret dhe aktual të ndikimit të kërkuesit në marrjen ose vërtetësinë e provave, duke mos evidentuar as veprime të tij që synonin ndikimin te dëshmitarët. Po kështu, për sa i përket rrezikut të largimit, gjykata e apelit nuk ka identifikuar rrethana konkrete dhe aktuale që të justifikonin ekzistencën e këtij rreziku, ndërkohë që nuk rezultonin as të dhëna për përpjekje të kërkuesit për t'iu shmangur procedimit penal. Në këto kushte, vlerësoj se gjykata e apelit nuk ka justifikuar mbi bazën e rrethanave konkrete se kufizimi i lirisë së lëvizjes ishte ende i nevojshëm për përmbushjen e qëllimit legjitim të garantimit të mbarëvajtjes së procedimit penal. Për më tepër, duke pasur parasysh se detyrimi për t'u paraqitur dy herë në muaj në Policinë Gjyqësore nuk kufizon kontaktet e kërkuesit me dëshmitarët dhe as lëvizjen e tij jashtë ditëve të përcaktuara për paraqitje, nuk rezulton e qartë se në çfarë mënyre kjo masë ishte e përshtatshme për parandalimin e rreziqeve të identifikuara.

8. Në këtë kuptim, vlerësoj se mënyra sesi GJKKO-ja e Apelit ka trajtuar vendimmarrjet e mëparshme, duke u njohur atyre efekte të parimit *res judicata* në vlerësimin e nevojave të sigurimit, vë në dyshim karakterin parandalues të masës së sigurimit. Në veçanti, referimi te mosrespektimi nga kërkuesi i detyrimeve të mëparshme procedurale, që kishte shërbyer si shkak për rëndimin e masës së sigurimit, krijon përshtypjen se vijimi i kufizimit të lirisë së lëvizjes ka marrë karakter ndëshkues, duke u larguar nga qëllimi për të cilin parashikohen masat e sigurimit. Po kështu, trajtimi i vlerësimeve të mëparshme për nevojat e sigurimit si përcaktuese për vendimmarrjen e re, pa një shqyrtim të plotë të rrethanave aktuale, merr rëndësi edhe në këndvështrimin e standardit objektiv të paanshmërisë së gjykatës, i cili kërkon që vendimmarrja gjyqësore të ofrojë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo

dyshim objektivisht të justifikuar për ekzistencën e një qëndrimi të paracaktuar. Në rastin konkret, mënyra e arsyetimit të gjykatës së apelit krijon dyshime nëse nevoja për mbajtjen e kërkuesit nën masë sigurimi është vlerësuar në mënyrë të pavarur, në raport me rrethanat aktuale të çështjes, ose është konsideruar e mirëqenë mbi bazën e vendimmarrjeve të mëparshme.

9. Për sa më lart, vlerësoj se GJKKO-ja e Apelit, duke e mbështetur vijimin e masës së sigurimit në vlerësimet e mëparshme gjyqësore, pa kryer një rivlerësim të mjaftueshëm të nevojave aktuale të sigurimit dhe pa evidentuar rrethana konkrete që justifikonin rrezikun e largimit ose të ndikimit në marrjen ose vërtetësinë e provave, ka vendosur një kufizim të lirisë së lëvizjes që nuk rezulton të jetë në përpjesëtim me nevojat konkrete të sigurimit në fazën në të cilën ndodhej procedimi penal. Fakti që masa e caktuar ishte më e lehtë se masa e mëparshme *"Arresti në shtëpi"* nuk mjafton, në vetvete, për të përligjur proporcionalitetin e saj, pasi çdo kufizim i një të drejte kushtetuese duhet të justifikohet në raport me qëllimin legjitim dhe rrethanat konkrete që kërkojnë vendosjen e tij. Për rrjedhojë, në vlerësimin tim, masa e caktuar nga GJKKO-ja e Apelit është joproporcionale dhe ka cenuar lirinë e lëvizjes së kërkuesit, në kundërshtim me nenin 38 të lidhur me nenin 17 të Kushtetutës.

10. Në përfundim, bashkohem me përfundimin e shumicës se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë së lëvizjes është i bazuar. Megjithatë, vlerësoj se në arsyetimin e këtij përfundimi duhej të vendosej theksi te joproporcionaliteti i masës së sigurimit të caktuar nga GJKKO-ja e Apelit, si pasojë e mosrivlerësimit të nevojave aktuale të sigurimit dhe mungesës së një justifikimi konkret për vijimin e kufizimit të lirisë së lëvizjes, dhe jo vetëm te pamjaftueshmëria e arsyetimit të vendimeve gjyqësore në drejtim të nevojës dhe të përshtatshmërisë së masës së sigurimit. Për këtë arsye, vlerësoj se kërkesa duhej të pranohej në tërësi, duke u shfuqizuar edhe vendimi i GJKKO-së së Apelit dhe duke u kthyer çështja për rishqyrtim po në atë gjykatë.

Anëtare: **Sonila Bejtja**

MENDIM PAKICE

1. Ne gjyqtarët Marsida Xhaferllari dhe Asim Vokshi jemi kundër vendimmarrjes së shumicës dhe vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se gjatë hetimeve paraprake, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka caktuar ndaj kërkuesit masat e sigurimit personal *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* dhe *"Ndalimi i daljes jashtë shtetit"*. Në vijim, për shkak të mosrespektimit të detyrimit për t'u paraqitur, me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023, masa e sigurimit është zëvendësuar me masën më të rëndë *"Arresti në shtëpi"*. Pas përfundimit të hetimeve paraprake dhe dërgimit të çështjes për gjykim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 674/2024, ka pranuar kërkesën e kërkuesit për revokimin e kësaj mase. Megjithatë, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 1/2025, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se nevojat e sigurimit vijonin të ekzistonin, por ishin zbutur dhe ka vendosur zëvendësimin e masës *"Arresti në shtëpi"* me masën *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dy herë në muaj*. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-658, datë 22.04.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

3. Shumica ka vlerësuar se, ndonëse GJKKO-ja e Apelit kishte identifikuar nevojat e sigurimit që vijonin të ekzistonin, ajo nuk kishte dhënë arsye konkrete dhe të mjaftueshme për të justifikuar nevojën dhe përshtatshmërinë e masës së zgjedhur, në raport me rrezikun për marrjen ose vërtetësinë e provave dhe atë të largimit të kërkuesit. Po kështu, shumica ka konstatuar se Gjykata e Lartë nuk i kishte kthyer përgjigje të mjaftueshme pretendimit të kërkuesit për cenimin e lirisë së lëvizjes në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit. Për rrjedhojë, shumica ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesit është i bazuar dhe vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet (*shih paragrafët 58-60 të vendimit*).

4. Në vlerësimin tonë, analiza e proporcionalitetit të masës së sigurimit duhet të mbajë parasysh jo vetëm nevojat e sigurimit që synohen të përmbushen, por edhe natyrën dhe intensitetin e kufizimit që masa konkrete sjell për individin. Në këtë drejtim, masa *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"* është një nga masat më pak kufizuese të parashikuara nga legjislacioni procedural penal. Në rastin konkret, detyrimi i kërkuesit për t'u paraqitur vetëm dy herë në muaj, në ditë të përcaktuara, nuk e pengon atë të lëvizë lirisht dhe as të ushtrojë veprimtarinë e tij politike e publike. Për më tepër, rezulton se në rastet kur kërkuesi ka kërkuar leje për të mos u paraqitur në policinë gjyqësore në ditët e përcaktuara, organi i

prokurorisë i ka miratuar kërkesat e tij, çka tregon se zbatimi konkret i masës nuk ka sjellë *de facto* kufizime të mëtejshme në lirinë e lëvizjes dhe as në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Për rrjedhojë, ndonëse masa përbën një ndërhyrje në lirinë e lëvizjes, intensiteti minimal i kufizimit duhet të vlerësohet në raport me detyrimet konkrete që ajo i vendos kërkuesit dhe qëllimin legjitim të garantimit të mbarëvajtjes së procedimit penal. Proporcionaliteti i masës nuk mund të shqyrtohet i shkëputur nga intensiteti i kufizimit që ajo sjell për individin, pasi edhe në kushtet kur nevojat e sigurimit vijojnë të ekzistojnë, natyra dhe ashpërsia e masës konkrete marrin rëndësi për vlerësimin e përputhshmërisë së saj me kriteret kushtetuese.

5. Në këtë kuptim, vlerësojmë se GJKKO-ja e Apelit ka marrë në konsideratë rrethanat konkrete të çështjes dhe fazën në të cilën ndodhej procedimi penal. Ajo ka evidentuar se, megjithëse hetimet paraprake kishin përfunduar, gjatë gjykimit mbetej për t'u realizuar pyetja e një numri të konsiderueshëm dëshmitarësh (137 dëshmitarë dhe 5 të bashkëpandehur), ndërsa natyra dhe kompleksiteti i çështjes kërkonin vijimin e vlerësimit të rrezikut për marrjen ose vërtetësinë e provave. Gjykata e apelit ka marrë në konsideratë edhe sjelljen e kërkuesit, konkretisht deklarimet publike të tij, të cilat i ka vlerësuar në drejtim të rrezikut të ndikimit te dëshmitarët, si dhe rrezikun e largimit. Nga ana tjetër, ajo ka pranuar se nevojat e sigurimit ishin zbutur, duke mbajtur parasysh kohën e kaluar nën masën *"Arresti në shtëpi"* dhe faktin se pjesa më e madhe e provave shkresore ishte administruar. Në këto kushte, zëvendësimi i masës së mëparshme me detyrimin për t'u paraqitur dy herë në muaj tregon se gjykata e apelit ka kryer një vlerësim konkret të nevojave të sigurimit në raport me rrethanat e ndryshuara të çështjes, çka është brenda marzhit të vlerësimit të gjykatave të zakonshme dhe nuk konstatohet të jetë dukshëm i pabazuar. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, pasi ka evidentuar argumentet kryesore mbi të cilat GJKKO-ja e Apelit kishte mbështetur vendimmarrjen e saj, ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk ishin të bazuara, duke konfirmuar, në këtë mënyrë ligjshmërinë e përfundimeve të gjykatës së apelit për vijimin e nevojave të sigurimit dhe përshtatshmërinë e masës së caktuar.

6. Po kështu, nuk ndajmë qëndrimin e shumicës lidhur me pamjaftueshmërinë e arsyetimit të GJKKO-së së Apelit për përshtatshmërinë e masës së caktuar, në veçanti për shkak se kjo masë nuk ndalon kontaktimin e dëshmitarëve ose nuk vendos kufizime të tjera të lëvizjes së kërkuesit. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se, sipas nenit 228, pika 3, shkronja "a", të KPP-së, vënia në rrezik e marrjes ose e vërtetësisë së provës përbën një nga kushtet e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit, i zbatueshëm për të gjitha këto masa dhe jo vetëm për ato që sjellin kufizime më të rënda të lirisë. Për rrjedhojë, vlerësojmë se përshtatshmëria e masës së caktuar nuk mund të vihet në dyshim vetëm për shkak se ajo nuk prodhon të njëjtat efekte kufizuese si masat më të rënda të sigurimit. Një vlerësim i tillë bëhet

në funksion të natyrës dhe qëllimit të masës konkrete, duke mbajtur parasysh edhe rrethanat individuale të çështjes. Në këtë kuptim, janë gjykatat e zakonshme ato që ndodhen në pozitë më të mirë për të vlerësuar nëse masa e zgjedhur është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për përmbushjen e nevojave të sigurimit, duke respektuar njëkohësisht kriterin e proporcionalitetit, sipas të cilit kufizimi nuk duhet të shkojë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e qëllimit të ligjshëm.

7. Për sa i përket referimit të GJKKO-së së Apelit te vendimmarrjet e mëparshme, vlerësojmë se përdorimi i tyre si pika referimi për ekzistencën dhe vijimin e nevojave të sigurimit nuk është, në vetvete, i papajtueshëm me kërkesat kushtetuese, sa kohë që gjykata pranon se vijojnë të ekzistojnë të njëjtat nevoja sigurimi. Në këtë drejtim, vijimi i një mase sigurimi nuk kushtëzohet domosdoshmërisht nga ekzistenca e rrethanave të reja, për sa kohë që nevojat e sigurimit që kanë përligjur caktimin e saj vijojnë të ekzistojnë. Për rrjedhojë, referimi i gjykatës te vendimmarrjet e mëparshme për të evidentuar këto nevoja nuk mund të konsiderohet, në vetvete, i papajtueshëm me standardet kushtetuese. Ndonëse vendimet e mëparshme për masat e sigurimit nuk krijojnë një pengesë për rivlerësimin e tyre në kuptim të parimit *res judicata*, rëndësi merr fakti nëse gjykata ka vlerësuar vijimin e nevojave të sigurimit në raport me rrethanat konkrete të çështjes dhe ka justifikuar proporcionalitetin e masës së zgjedhur. Në rastin konkret, sikurse u evidentua më sipër, GJKKO-ja e Apelit ka marrë në konsideratë edhe ndryshimin e fazës së procedimit penal dhe zbutjen e nevojave të sigurimit, duke ushtruar funksionet e veta gjyqësore sipas tagrave që i jep ligji.

8. Në këtë drejtim, vlerësojmë se edhe nëse disa nga argumentet e GJKKO-së së Apelit lidhur me efektet e vendimmarrjeve të mëparshme nuk janë të sakta, kjo rrethanë nuk mjafton për të arritur në përfundimin se vendimi i saj është arbitrar ose se ka cenuar lirinë e lëvizjes së kërkuesit. Në këtë kuptim, duhet mbajtur parasysh se vlerësimi i rrethanave faktike që përligjin nevojat e sigurimit u përket gjykatave të zakonshme, sidomos në rastin e masave minimalisht invazive si ajo e detyrimit për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore. Kontrolli kushtetues përqendrohet në verifikimin nëse kufizimi i së drejtës është justifikuar në përputhje me garancitë kushtetuese, veçanërisht në rastin kur masa e sigurimit nuk prek lirinë personale, por vendos thjesht një detyrim për t'u paraqitur në një vend të caktuar, i cili përbën ndërhyrje të papërfillshme në lirinë e lëvizjes dhe kjo e fundit nuk prevalon mbi nevojat e sigurimit të vlerësuara në mënyrë jo të paarsyeshme nga gjykatat e zakonshme, konform tagrave që u njeh ligji. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar nevojat e sigurimit që, sipas saj, vijonin të ekzistonin, ka marrë në konsideratë ndryshimin e rrethanave të çështjes dhe ka zgjedhur një masë më pak kufizuese. Për rrjedhojë, nuk rezulton që mangësitë e evidentuara në arsyetimin e saj të kenë një natyrë dhe rëndësi të tillë që të përbëjnë shkelje të standardit

kushtetues të proporcionalitetit dhe rrjedhimisht të ngrenë një çështje kushtetuese për të cilën justifikohet ndërhyrja nga Gjykata.

9. Gjithashtu, vlerësojmë se Gjykata e Lartë, në shqyrtimin e rekursit të kërkuesit, ka marrë në analizë përfundimet e GJKKO-së së Apelit për vijimin e nevojave të sigurimit, duke evidentuar se këto nevoja lidheshin me rrezikun për marrjen ose vërtetësinë e provave dhe atë të largimit. Ajo ka mbajtur parasysh edhe faktin se masa ishte zëvendësuar me një masë më të lehtë dhe ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk ishin të tilla që të cenonin vendimmarrjen e gjykatës së apelit. Në këto rrethana, fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk do të thotë se ajo nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, për sa kohë që nga arsyetimi i vendimit rezulton se ka shqyrtuar ligjshmërinë e përfundimeve të gjykatës së apelit dhe i ka konsideruar ato të mbështetura në dispozitat përkatëse të KPP-së.

10. Për sa më lart, në vlerësimin tonë, vendimmarrjet gjyqësore të kundërshtuara, të shqyrtuara në tërësinë e tyre, përmbajnë një arsyetim të mjaftueshëm për vijimin e nevojave të sigurimit dhe zëvendësimin e masës nga *"Arrest në shtëpi" në atë të "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, i cili nuk rezulton të jetë arbitrar. Duke mbajtur parasysh natyrën e masës së caktuar, intensitetin minimal të kufizimit që ajo sjell për kërkuesin, rrethanat konkrete të çështjes dhe fazën e procedimit penal, bazuar në arsyetimin e gjykatave të zakonshme, të cilat janë në pozitë më të mirë për të vlerësuar faktet e çështjes, nuk rezulton që kufizimi i lirisë së lëvizjes të jetë joproporcional në kuptim të nenit 38 të lidhur me nenin 17 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë së lëvizjes të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar dhe kërkesa duhej të rrëzohej.

Anëtarë: **Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi**